BURIMI
BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË
SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

## Gusht 2022

### RUAJ DATËN! - Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike, 8-9-10 Nëntor 2022, Prishtinë, Kosovë

## Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve

Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotur për Menaxherët dhe Inxhinierët
Shtator-Nëntor 2022

Riparimi dhe Rehabilitimi i Sistemit të Kanalizimeve
28-29 Shtator 2022, Tiranë

## Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

Kongresi dhe Ekspozita Botërore e Ujit e IWA, Shtator 2022

Kopenhagen, Danimarkë
11-15 Shtator 2022

Konferenca dhe ekspozita teknike vjetore e 95-të




## Thirrja për Abstrakte është tashmë e hapur – Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme, Konferenca dhe Ekspozita e 10-të e Përbashkët Ballkanike




Pas dy vitesh organizimi të konferencave virtuale, SHUKALB dhe SHUKOS kanë kënaqësinë t'ju ftojnë të na bashkoheni **fizikisht** në Konferencën dhe Ekspozitën tonë të 10-të të Përbashkët Ballkanike që do të mbahet më **8-9-10 Nëntor 2022, në Prishtinë, Kosovë**.

New Orleans, Lousian, SHBA
8-12 Tetor 2022

Samiti Dixhital i Ujit

Bilbao, Spanjë
29 Nëntor – 2 Dhjetor 2022

## Bashkohuni me Ne!




## Na tregoni se cfarë mendoni!

## Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale,

Tema e Konferencës, **Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme**, është frymëzuar nga Dita Botërore e Ujit 2022, dhe sjell vemendjen tek rëndësia që ka mbrojtja cilësore dhe sasiore e burimeve tona nëntokësore. Tema është e një rëndësie të veçantë për vendet si Ballkani Perëndimor, të cilët mbështeten shumë në ujërat nëntokësore për nevojat e tyre të furnizimit me ujë. lexo më shumë

---

## Lajme nga Sektori

### Krijohen 7 Shoqëri të reja Rajonale Ujësjellës Kanalizime në kuadër të Reformës së re në Sektor




Gjatë muajit korrik 2022, u krijuan 7 Shoqëri të reja Rajonale Ujësjellës Kanalizime duke e çuar në dhjetë (10) numrin total të Shoqërive të reja UK Rajonale në të gjithë Shqipërinë, përfshirë shoqëritë Durrës, Korçë dhe Pogradec, të cilat e përfunduan procesin gjatë muajit qershor 2022. lexo më shumë

---

## Çfarë ka të re në SHUKALB!

### SHUKALB përgatit dhe zhvillon me sukses workshopin "Menaxhimi i Ujërave të Ndotur në Kontekstin e Ekonomisë Qarkulluese"

jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon te përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më efiçent, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.




Gjatë datave 18-19 korrik 2022, SHUKALB dhe Global Water Partnership-Mediterranean (GWP-Med) organizuan me sukses workshopin 2-ditor me temë ” Menaxhimi i Ujërave të Ndotur në Kontekstin e Ekonomisë Qarkulluese”. Workshopi u përgatit dhe u mbajt nga SHUKALB në kuadër të Projektit SEE NEXUS, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe zbatuar nga GWP-Med në partneritet me UNECE. Workshopi u përshëndet në hapje nga Arduen Karagjozi, Drejtor i Menaxhimit Strategjik, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Tassos Krommydas, Zyrtar i Lartë i Programit, GWP-Med. lexo më shumë

---

## Trajnime dhe programe të zhvillimit të kapaciteteve

### Thirrje për pjesëmarrje në programin e zhvillimit të kapaciteteve me temë ”Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët”



SHUKALB ka kënaqësinë t’ju ftojë të merrni pjesë në Programin e Zhvillimit të Kapaciteteve për Kanalizimet dhe

Ujërat e Ndotura me titull “Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët”, i cili do të pilotohet për herë të parë në kuadër të Projektit “Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (RCDN)”.

Programi konsiston në 3 trajnime mbi temat e aspekteve rregullatore, financuese, teknologjike dhe të menaxhimit të një projekti infrastrukturor, si dhe një shkëmbim mes kolegësh, i cili do të organizohet gjatë muajve shtator – nëntor 2022. lexo më shumë

Anëtarësohuni në SHUKALB | Kurset e Trajnimit | Na kontaktoni

**Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë,**
Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019,Tirane, Shqiperi
Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782
**E-mail:** info@shukalb.al**, Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu